

AIDA SESERI MARTIRO

Rr. Zyber Preza, Pall 96, Apt.19, Tirane

Email: aida.martiro@gmail.com

Tel: (069) 40-10-480

Eksperienca Profesionale

11Maj 2018 - në
vazhdim

AGJENCIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Drejtores e Drejtorisë së Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave

- Drejton punën për të asistuar Autoritetet Kontraktore në hartimin e kritereve në fazën e shpalljes së procedurave të prokurimit publik.
- Analizon raportimet e autoritetve kontraktore, nga faza e lidhjes së kontratës dhe harton programin e monitorimit të tyre.
- Monitoron institucionet mbi zbatimin e kontratave, në përputhje me aktet ligjore.
- Përfaqson Agjencinë e Prokurimit Publik në grupeve të kontrollit të Taskë-Forcës Antikorrupsion me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Nentor 2013 –
Janar 2018

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Drejtores e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit

- Drejton Programin “Planifikimi Urban dhe Strehimi” për 4 vjet , objektivi i të cilit ka qënë të hartojë, të mbështesë dhe zbatojë procese dhe politika për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, kontrollin e territorit, administrimin e tokës, strehimin, mbetjet urbane, si dhe legalizimin, urbanizimin e integrimin e zonave informale.
- Drejton departamentin e Shërbimeve Urbane dhe e Strehimit, objektivi i të cilëve është të hartojë politika në fushën e Shërbimeve Urbane: Mbetjeve të Ngurta, Strehimit dhe Infrastrukturës.
- Propozon investimet për planifikimim e mbetjeve urbane dhe strehimit për projekt-buxhetin, në përputhje me programin e qeverisë dhe me nevojat e njësisve të vetëqeverisjes vendore.
- Vlereson dhe miraton projekte të hartuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat adresojnë nevojat e komuniteteve në nevojë për strehim.
- Iniciei dhe krijoi bazën e të dhënave shtetërore për hartën dixhiale ndëraktive të mbetjeve të ngurta urbane , ku janë identifikuar venddepozitat egzistuese në të gjithë vendin. Shqipëria për herë të parë krijoi një hartë e cila është pjesë e Gjeoportalit Kombëtar në ASIG, si një shtresë e vecantë për tematikën e mbetjeve e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 428 datë 08.06.2016.
- Përgjegjëse për ndjekjen dhe hartimin e masterplanit të mbetjeve të ngurta urbane në bashkëpunim me Bankën Gjermane (KFË), i cili do të identifikojë te gjithë nevojat për investime në menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri dhe do të përcaktojë metodologjinë e përshtatshme të trajtimit të tyre.
- Bashkëpunetore për hartimin e “Strategjisë së Strehimit Social”, si dokumenti i parë politik në këtë fushë, pas 27 vjetësh tranzicion, miratuar me VKM nr 405 datë 1.06.2016
- Bashkëpunetore për hartimin ligjit të ri “Për strehimin social” i cili u miratua në qeveri me VKM nr 311 datë 12.04.2017 dhe pritet të kalojë në komisionet parlamentare dhe më pas në parlament.

- Anëtare e Bordit të Entit Kombëtar të Banesave.
- Anëtare e komisionit mbi licensimin e individëve dhe kompanive në fushën e projektimit dhe supervision- kolaudimit në ndërtim.

Qershor 2011 –
Tetor- 2013

UNIVERSITETI I ARTEVE
Specialiste, Sektori i Investimeve

TIRANE

- Hartoi projekt-buxhetin për investimet me karakter ndërtimor dhe identifikoi nevojat dhe kërkesat sipas kushteve aktuale të fakulteteve, përfshirë hartimin e preventivave dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik për investimet.
- Ndoqi mbarvajtjen dhe supervizionin në investimet e institucionit të financuara nga fondet publike të shtetit, të vetë institucionit dhe të financuesve ndërkombëtare.
- Iniciei dhe supervizoi të gjitha punimet ndërtimore të miratura nga Rektorati me financime nga të ardhurat e institucionit për mirëmbajtjen e ambienteve akademike, klasa, salla lektoriumi, salla e lëvizjes skenike, të cilat karakterizohen nga specifika të vecanta si ambiente arti.

Shkurt 2012 –
Mars 2013

FONDACIONI SHQIPTARO-AMERIKAN I ZHVILLIMIT
Konsulente

TIRANE

Mbarti përgjegjësinë e zbatimit të disa financimeve për projekte publike, përfshirë:

- Dy projekte të mëdha pedonale në Korçë (Ruga 13 Tetori dhe 28 Nentori) dhe pedonale në Shkodrë. Ndoqi dhe zbatoi projektin sipas të gjithë zërave të preventivit, shqyrtoi dhe miratoi ndryshimet e projektit për punimet shtesë, verifikoi matjet në vend, kontrolloi volumet e punimeve nga fillimi i zbatimit deri tek dorezimi i objektit drejt pushteti vendor.
- Përgatiti paketën e plot teknike dhe hartoi dokumentacionin nga ideimi e deri në fazën e konkurimit duke përfshirë matjet në teren dhe hedhjen në hartë, preventivat për punimet e ndërtimit dhe punimet me karakter mjedisor në përputhje me fondet e organizatës.

2005 – 2010

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONEVE (MPPT)
Drejtores, Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Komunitare

Në krye të drejtorisë me të madhe në MPPT, me përgjegjësi për sektorët e Ujësjellesave, Mbetjeve të Ngurta dhe Emergjencave Civile. Menaxhoi një staf administrativ prej 11 specialistësh. Negocioi kontrata me sipërmarres ndërtimi vendas dhe të huaj si edhe konsulente dhe agjensi shtetërore. Ka kryesuar komisione ministrore dhe ka përfaqësuar MPPT në Këshillin nder-Ministror për Mbrojtjen e Konsumatorit. Vlerësoi tendera publik si anëtare në komisionet vendimarrëse.

Shembujt të përzgjedhur negociimi dhe studimesh teknike:

- Negocioi me Qeverinë Hollandeze kontratën e reabilitimit të sistemit për furnizim uji të pishëm për qytetin e Vlores
- Negocioi kontratat e instalimit të impianteve të trajtimit të ujrave për rrethet Durrës, Lezhë dhe Sarandë
- Mori pjesë në përgatitjen e studimit final për shfrytëzimin komercial të burimeve ujore të Shqipërisë së Jugut

Shembujt të Përzgjedhur si Kryetare Komisionesh Ministrore:

- Komisioni i posaçëm për masat urgjente për rimëkëmbjen e infrastruktures pas tragjedisë së Gërdecit
- Komisioni për mbikqyrjen teknike dhe ligjore të projektit për ndërtimin e pjesëve të ujësjellësit kryesor të qytetit të Peshkopisë
- Komisioni për transferimin e disa objekteve të privatizuara të sistemit të ujësjellësive

Shembuj të Përzgjedhur si Anëtarë në Komisionet e Tenderimit:

- Përzgjedhja e kontraktorit primar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta për Tiranën
- Përzgjedhja e konsulentëve lokale e ndërkombetare për përgatitjen e planit për gropëmbushjen e Bajkalit
- Përzgjedhja e kontraktorëve për ndërtimin e disa stacioneve uji në mbarë vendin.

Prill 2007 –
Ne Vazhdim

Supervizore dhe Kolaudatore

Ushtron në vazhdimësi përgjegjësinë e mbikqyrjes dhe kontrollit të projekteve në punimet e gjithë infrastruktures publike përfshirë ndjekjen e procesit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit sipas parametrave evropian duke marrë parasysh dhe anën financiare. Gëzon një ndër eksperiencat më të pasura supervizionesh të pavarura të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që përfshijnë në gamë ndërtime të reja, rregullime dhe rikonstruksione rrugësh qendrore dhe rurale, godina institucionesh publike, ujësjellësa etj. Mbart një ndër liçensat më të gjera të supervizionit falë përmbushjes së kriterit të një eksperience mbi 20 vjetecare në zbatim ndërtimesh.

Shembuj të Përzgjedhur Supervizionesh dhe Kolaudimesh:

- Rikonstruksioni i ambjentëve të mëdha të Kuvendit të Shqipërisë
- Rregullimi i hyrjes kryesore në Bashkinë e Fierit e rrugës së Komunës Grecalli
- Rikonstruksioni i rrugës kombëtare në fshatin Lapardha, Komuna Otlak
- Ndërtimi i shkollave 9-vjecare në Bashkinë e Golemit dhe në Lunder, Komuna Farke
- Ndërtimi i sinjalizimit dhe sistemit të trafikut për segmentin e rrugës Dushkazenaj-Rezervuari-Seferaj në Bashkinë e Kavajës
- Ndërtimi i Depos së Ujësjiellit në fshatin Koxhas, Komuna Xhafzotaj
- Kryetare bordi për Ndermarjet e ujësjiellit-kanalimet në qytetet: Tepelenë e Skarpar

2001 – 2005

BASHKIA E TIRANËS

Specialiste me Statusin e Nënpunësit Civil, Drejtoria e Kontrollit të Territorit

- Mbikqyrja hapësirave publike dhe kontrollin e shkeljeve ligjore të personave fizike dhe ligjore, përfshirë: ndërtime të paligjshme, ndotje të ujit të pijshëm, sistemin e ujërave të zeza dhe ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin elektrik dhe telefonik.
- Drejtoi grupet e punës për zbatimin e Ligjit për kompanitë që ushtrojnë biznesin e ndërtimit. Puna u fokusua në mbikqyrjen e rregullave për largësinë mes ndërtesave dhe detyrimeve ligjore të përcaktuara në lejet e ndërtimit përkatëse të aprovuar nga KRRT e Bashkisë së Tiranës.
- Administroi programin e Bashkisë për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga objektet tregtare dhe ndërtimore në qytetin e Tiranës. Mbikqyrja respektimin e rregullave për oret dhe metodat e hedhjes së këtyre mbetjeve dhe ushtroi sanksionimin e gjobave administrative ndaj shkelësve të këtyre rregullave.

1999 – 2001

FIRMA PRESPA Sh.p.k.

Menaxhere dhe Drejtore Teknike

- Manaxhoi dhe mbikqyrja 30 punëtorë dhe staf teknik. Drejtore teknike për prodhimin e blloqeve të parafabrikuar dhe integrimin e tyre në objekte ndërtimore.
- Manaxhere prodhimi për lloje të ndryshme materialesh ndërtimi, si soleta te paranderura betoni, blloqe betoni, arkitrare mbajtes, kolona dhe objekte dekorative.

- Përgjegjëse për prodhimin e zhavorrit të lumit nëpërmjet makinerisë gurë-thyese dhe për përpunimin e lëndës së pare për prodhimin e zhavorrit të llojit #1, zhavorrit të llojit #2, rërës së gurit dhe rërës natyrore.
- Përgjegjëse për mbikqyrjen teknike dhe zbatimin e objekteve të ndertimit, përfshirë ndërtimin e Poligonit të Qitjes së RENEAs dhe ujësjellësit të RENEAs në Tiranë.

1991 – 1998 **NDËRMARRJA KOMUNALE E BANESAVE (“NKB”)**

Inxhinierë Ndertimi

- Koordinoi programin e privatizimeve të banesave në zonën e Kombinatit (Zona Nr. 6) duke ofruar ekspertizë inxhinierike pranë NKB Nr. 2.
- Përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe manaxhimin e gjithë ndërtesave të banimit në Laprake (Zona Nr. 4 dhe nr. 7) dhe godinave qeveritare të administruara nga Ndërmarrja e Menaxhimit të Objekteve Sociale nën mbikqyrjen e NKB.
- Përgjegjësi të tjera përfshinin mirëmbajtjen dhe rikonstrukcionin e hapësirës së brendshme të disa ndërtesave qeveritare.

Arsimi

UNIVERSITETI EVROPIAN I TIRANËS

Master i Nivelit të Dytë – Urbanizimi, Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Politikat e Mjedisit

UNIVERSITETI I TIRANËS

Kurs Pasuniversitar dy vjecar i financuar nga program Tempus i Bashkimit Europian me tezen: Njohuri të Reja për Mbështetjen e Politikës së Transportit në Shqipëri

UNIVERSITETI I TIRANËS

Përfundoi studimet e larta për Inxhinieri Ndertimi në Fakultetin e Shkencave të Naturës.

**Aktivitete
Sociale**

- Përfaqesuese e Konsullit të Nderit të Shqipërisë në Neë Orleans për Tiranën
- Koordinuese e Programit të Shkëmbimit të Studenteve midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Neë Orleans, SHBA